REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A "UJËSJELLËSI" KURBIN
ASAMBLEJA E AKSIONERËVE

100 Vjet Paraardhës

Nr. 1 prot

Laç, me 15/05/2013

VENDIM

NR. 1 Datë 15/05/2013

Sot me daten 15.05.2013, u mblodh Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqërisë Anonime "Ujësjellësi" Kurbin, bazuar në kërkesën e Drejtorit per thirjen e kesaj mbledhje. Ne mbledhje marrin pjese 53.7% e aksionereve. Njoftimi per thirrjen e mbledhjes eshte bere ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 neni 136-139 . Thirrja eshte bere me njoftim te drejt per drejt:

Pas diskutimeve te bera per pikat e rendit te dites: Për hartimin e statutit të ri të Shoqërisë te përshtatur me ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ne rikonfirmimin e organeve drejtuese te shoqerise dhe te eksperteve kontabel te autorizuar, Asambleja e ortakeve me 100% te votave te pjesemarresve:

VENDOSI:

1. Te miratohet statuti i ri i shoqërisë anonime "Ujësjellësi" Kurbin, i përshtatur me ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 230 dhe disa ndryshime te tjera, sipas kërkesave te ligjit. Ky statut hyn në fuqi menjehere.
2. Ngarkohet Drejtori i shoqerise te beje depozitimin e ketij vendimi dhe Statutit te ri, ne Qendren Kombetare te Regjistrimit Tirane.

Kryetarja e Asamblesë së Aksionerëve.
Znj. Flora Myrta

Sekretari
Avokat Edmond Bunaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E RREGULLIMIT TE TERRITORIT DHE TURIZMIT - UJESJELLESI SH.A. KURBIN

STATUTI I SHOQËRISË ANONIME

SH. A. "UJËSJELLËS" KURBIN

Ky statut është hartuar mbi baznë e ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sot më datë 15.05.2013.

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria emërtohet Sh.A "Ujësjellës" Kurbin.

Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë është në Kurbin. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

Neni 3

Shoqëria, sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të asamblesë së aksionarëve.

Neni 5

Objekti i shoqërisë është:

1.Sherbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

2.Mirëmbajtja e sistemit (eve) të furnizimit me ujë të pijshëm.

3.Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve.

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, liçensave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente.

Neni 6

Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 181,000,000 lekë dhe është ndarë në 181,000 aksione me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secili. Kapitali i shoqërisëështë derdhur dhe nënshkruar tërësisht.

Neni 7

Aksionet

1.Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

2.Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit apo titullarëve në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësave financiarë.

3. Aksionet zotërohen si më poshtë:

- 46.3% e aksioneve zotërohen nga Bashkia Laç
- 33,9% e aksioneve zotërohen nga Bashkia Mamurras
- 19.8% e aksioneve zotërohen nga Komuna Milot

Neni 8

Asambleja e aksionarëve (Të drejtat dhe detyrimet)

1.Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) përcaktimin e politikave tregtare;

b) ndryshime të statutit;

c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, emërimin dhe revokimin e Adminstratorit.

ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;

dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;

gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;

h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;

c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;

ç) vendimet për investime;

d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Neni 9

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1.Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji për shoqëritë tregtare, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2.Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe, në rastet e parashikuara nga ligji 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

3.Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

4.Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5.Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6.Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.

7.Dispozita e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.

8.Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e organeve administrative.

Neni 10

Mënyra e thirrjes

1.Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:

a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;

b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:

i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të këtij ligji;

ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;

iii) proçedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;

c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 138 të këtij ligji;

ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

3. 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:

a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;

b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;

c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme.

4. Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë se përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

Neni 11

Rendi i ditës

1.Rendi i ditës, që njoftohet sipas nenit 137 të ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.

2.Nëse asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

3. Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkese me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

4.Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij neni dhe të nenit 137 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12

Proçesverbalet e mbledhjeve të asamblesë

1.Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në proçesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e proçesverbaleve.

2.Proçesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të proçesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.

3.Proçesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4.Proçesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

5.Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të proçesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshmenë faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 13

Në mbledhjet e asamblesë së aksionarëve përfaqësuesit e bashkive/komunave paraqiten me vendimin dhënë nga Këshillat Komunalë/Bashkiakë si përfaqësues të tyre në këtë asamble sipas formatit te percaktuar nga Q.K.R.

Neni 14

Kuorumi

1.Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë", asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.

2.Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Marrja e vendimeve

1.Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 144 tëtë Ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" , në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2.Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 135 të Ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Ligjin nr. 9901 dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, në statut apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

Neni 16

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të Sh.A. "Ujësjellës Kanalizime" Kurbin janë:

1. Këshilli Mbikqyrës
2. Administratori (Drejtori i Përgjithshëm)

Neni 17

Këshilli Mbikqyrës

Përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të vendimit nr. 642 datë 11.10.2007 të Këshillit të Ministrave "Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore", të ndryshuar, Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 6 anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Nëse një aksionar i vetëm zotëron më shumë se ½ e aksioneve të shoqërisë, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës zgjidhen si më poshtë:

-Aksionari që zotëron më shumë se ½ e aksioneve të shoqërisë zgjedh 50+1 % të numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

-Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikqyrës zgjidhen nga aksionarët e tjerë.

- Ne rastin aktual te shoqerise "Ujesjellesi" Kurbin kur asnje nga aksioneret e shoqerise nuk zotron me shume e 50+1 % te aksioneve çdo aksionere do te zgjedhe 2 anetare te Keshillit Mbikqyres

Neni 18

Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Mbikqyrës, është 3 vjet.Ata mund të rizgjidhen pa kufizim. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë persona fizikë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të Këshillit Mbikqyrës, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje.

Neni 19

Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1-Në rastin e vendeve bosh, që krijohen nga vdekja apo dorëheqja e një apo disa anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, ky Këshill mundet, për periudhën midis dy mbledhjeve të asamblesë, të bëjë emërime të përkohshme, duke pasur parasysh parashikimet e nenit 17 të statutit.

2.Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës ka zbritur nën minimumin ligjor, Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) duhet të thërrasë urgjentisht mbledhjen e Asamblesë për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

3.Emërimet e bëra nga Këshilli Mbikqyrës në bazë të paragrafit 1 të këtij neni i nënshtrohen ratifikimit në mbledhjen e radhës së asamblesë.

4.Nëse një ose disa vende të Këshillit Mbikqyrës mbeten bosh për shkak vdekje, shkarkimi ose dorëheqje të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, zëvendesimi i tyre duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga koha në të cilën vendi ka mbetur bosh.

5.Anëtari i Këshillit Mbikqyrës i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

Neni 20

Kufizimi i mandateve

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë Sh.A."Ujësjellës" Kurbin, të emëruar nga asambleja e aksionarëve, nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

Asnjë anëtar i Këshillit Mbikqyrës nuk mund të bëjë pjesë në më shumë së 2 (dy) Këshilla Mbikqyrës të shoqërive anonime që kanë seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 21

Kryetari dhe Zëvendës/Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

1.Këshilli Mbikqyrës zgjedh nëpërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikqyrës dhe mund të jenë të rizgjedhshëm.

2.Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton këtij dhe pagën.

3.Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës drejtohen nga Z/Kryetari.

Neni 22

Vendimet e Këshillit Mbikqyrës

1.Këshilli Mbikqyrës mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë anonime, me thirrjen e kryetarit ose, në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit.

2.Kryetari dhe në mungesë të tij zëvendëskryetari, duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

3.Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin Mbikqyrës duke i përcaktuar rendin e ditës.

4.Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë, telegram, fax, ose telex.

5.Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës.

6.Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.

7. Vendimet e këshillit Mbikqyrës vlerësohen të vlefshme, nëse në proçesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

LESI SH.A KUKËS

8.Këshilli Mbikqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e këshillit të pranishëm në atë mbledhje.

9.Vendimet e Këshillit Mbikqyrës pasqyrohen në proçesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit Mbikqyrës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

10.Kopje të këtyre proçesverbaleve vërtetohen nga kryetari (ose në mungesë të tij zëvendëskryetari) dhe sekretari.

Neni 23

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

1.Këshilli Mbikqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga Administratori dhe i jep këtij të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga Administratori pa autorizimin e Këshillit Mbikqyrës.

2.Këshilli mbikqyrës autorizon Drejtorin e Përgjithshëm që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 25 dhe 26 të statutit.

3.Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

4. Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) i paraqet raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli. Këshilli Mbikqyrës i propozon asamblesë së aksionarëve lidhur me këto çështje:

a-Përcaktimin dhe ndyshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.

b-Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së administratorit të shoqërisë.

c-Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masa të tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

d-Hapjen e veprimtarive ose njësive të tjera dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë.

e-Shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërive sipas legjislacionit në fuqi.

f-Krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera.

g-Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.

h-Si dhe për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e asamblesë së përgjithshme.

Neni 24

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të caktohet nga asambleja e aksionarëve, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.

Shoqëria njeh gjithashtu dhe shpenzimet e bëra nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli Mbikqyrës për probleme të kompanisë.

Neni 25

Administratori (Drejtori i Përgjithshëm)

1.Shoqëria administrohet nga Administratori (Drejtori i Përgjithshëm).

2.Administratori (Drejtori i përgjithshëm) ka të drejtë, që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.

3. Administratori (Drejtori i përgjithshëm) është person fizik, në të kundër emërimi i tij është i pavlefshëm. Për t'u zgjedhur Administrator (Drejtor i Përgjithshëm), personi duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.400 datë 19.08.1999. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një antëtar i Këshillit Mbikqyrës emërohet Administrator (Drejtor i Përgjithshëm), mandati i tij në Këshillin Mbikqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet Administrator (Drejtor i Përgjithshëm) në më shumë se një shoqëri. Ai nuk mund të jetë edhe mbi moshën 65 vjeç.

4.Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të zakonshme. Shkarkimi i tij bëhet për shkaqe të përligjura. Ai emërohet për një periudhë prej 4

vjetësh, por mbi baza kontratash të rinovueshme vjetore. Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) mund të riemërohet.

5.Paga e Administratorit (Drejtorit të Përgjithshëm) caktohet në aktin e emërimit të tij.

6.Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.

7. Në marrëdhënie me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Drejtorit të Përgjithshëm kapërcen objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe vepron me keqbesim ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e statutit që kufizojnë kopmetencat e Drejtorit të Përgjithshëm duhet të respektohen nga të tretët.

8.Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

9.Lidhja e kontratave me afat mbi 2 vjet apo me vlerë mbi 2 (dy) million lekë bëhet me autorizim të Këshillit Mbikqyrës. Në rastet emergjente dhe pamundësie për të mbledhur Këshillitn Mbikqyrës, për kontrata qëi kalojnë limitet e mësipërme duhet marrë miratimi me shkrim i Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës dhe në mungesë të tij të tij zëvendëskryetarit. Këta të fundit njoftojnë në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikqyrës, këtë të fundit për autorizimin e dhënë.

10.Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikqyrës.

11.Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) bën strukturën e orgamnizimit të shoqërisë, të cilën e miraton Këshilli Mbikqyrës.

Neni 26

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikqyrës

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshilit Mbikqyrës janë:

1.Të gjitha marrëveshjët që bëhen ndërmejt shoqërisë dhe Administratorit (Drejtorit të Përgjithshëm) apo një ndonjë anëtari të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë;

2.Marrëveshjet, me të cilat një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt, apo në të cilat ai lidhet me shoqërinë ndërmjet një personi ndërmjetës.

3.Marrëveshjet që veprojnë ndërmjet shoqërisë dhe një subjekti tjetër ekonomik të një lloji të çfarëdoshëm, në rast se Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) apo një nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë është pronar, ortak "I pakufizuar", administrator apo anëtar i drejtorisë së subjektit tjetër ekonomik.

Neni 27

Ekspertët Kontabël

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e aksionarëve dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 28

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 29

Inventari - llogaritë vjetore

1.Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore.

2.Në mbylljen e ushtrimit financiar, Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.

3.Administratori (Drejtori i Përgjithshëm) përgatit gjithashtu edhe raportin e administratimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Neni 30

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1.Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, pas zbritjes së amortizimeve dhe provizioneve.

2.Nga fitimet e ushtrimit, pasi të jenë zbritur, kur është rasti humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5% për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme. Kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar nuk bëhen heqje nga fitimet e ushtrimit.

3.Ajo (heqja) rifillon, kur për një arsye të çfarëdoshme, rezerva e domosdoshme ka zbritur në 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.

4. Përdorimi i fitimit bëhet me vendim të asamblesë së aksionarëve.

Neni 31

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas mënyrës dhe formës së përcaktuar në ligj.

Neni 32

Dispozita të përgjithshme

Për çfarë nuk është shprehur në statut, referimi bëhet në dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.

Aksioanrët

Për Bashkinë Laç **perfaqesuar nga** _____

Për Bashkinë Mamurras **perfaqesuar nga** FLORA MYRTA

Për Komunën Milot **perfaqesuar nga** BEHAR HAXHIU

SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËSI I BASHKISË KURBIN".
NIPTI K07628310A

Laç, më 12.05.2016.

VENDIM

NR.2, DATË 12.05.2016

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSËME TË AKSIONARËVE

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit Nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale në Republiken e Shqipërisë", të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare",i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve në mbledhjen e datës 12.05.2016 vendosi:

1. Të miratojë Statutin e Shoqërisë Aksionare "Ujësjellësi i Bashkisë Kurbin", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të depozitohet pranë QKB.
3. **Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

AKSIONARI I VETËM

BASHKIA KURBIN

ARTUR BARDHI

STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE

"LËSHELLËS KURBIN"

Ne mbledhjen themeluese mënyrën e njoftimit e ka bërë: [illegible]

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare njohëse me emërtimin "LËSHELLËS KURBIN" e me seli [illegible] [illegible] [illegible]